



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E
MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. ____ .prot

Korçë më ____ / ____ /2018

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE

Specialist për kontabilitetin
Niveli minimal i diplomës “Master profesional”
Në shkencat ekonomike
Kategoria III.b

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Korçë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

(një) Specialist për kontabilitetin, sektori i kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës, në Bashkinë Korçë - kategoria III-b.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele

Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant,

atëherë është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: **18.01.2018**

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: **23.01. 2018**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

- Përpilim i Urdhër – Shpenzimeve duke përfshirë kontrollin dhe plotësimin e dokumentacinit justifikues për likuidimin e trasaksioneve financiare, mjaftueshmërinë e fondeve të çelura dhe përputhshmëria me grafikët e likuidimeve.
- Përpilim i Urdhër – Shpenzimeve që kanë lidhje me shpërndarjen e ndihmës ekonomike, invaliditetin e punës, paaftësinë, verbërinë si dhe shtesës për para-tetraplegjikët.
- Depozitimi i Urdhër – Shpenzimeve në Degën e Thesarit.
- Shpërndarja e borderove në bankat përkatëse pas miratimit të shpenzimeve nga Dega e Thesarit.
- Përpilimi i tabelës së investimeve me përmbajtje të detajuar në lidhje me projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve si dhe përpilimi i të dhënave raportuese për ecurinë e këtyre projekteve në Ministrinë e Zhvillimit Urban brenda datës 5 të çdo muaji.
- Hartimi i urdhërave të brendshëm të Kryetarit për shlyerjen e detyrimeve.
- Përpilimi i evidencave që kanë lidhje me shpenzimet për energjinë elektrike, ujin, telefonin dhe shërbimet postare për Bashkinë Korçë, Njësitë Administrative dhe Qëndrat Komunitare.
- Hartimi i urdhërave të marrjes në dorëzim të mallrave, shërbimeve ose investimeve sipas faturës ose kontratës.
- Hartimi i shkresave përcjellëse dhe grafikëve të likuidimit për kontratat si dhe depozitimi i tyre në Degën e Thesarit Korçë duke zbatuar afatet ligjore.
- Pjesëmarrje në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave dhe zbatimi i legegjislacionit në fuqi për prokurimet publike.

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- d- Të zotërojnë minimalisht diplomë të nivelit “Master profesional” në shkenca ekonomik (bachelor dhe master)

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Korçë, dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Korçë, brenda datës **18.01.2018**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **20.01.2018**, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Korçë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Njohuri mbi ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar
- Njohuri mbi ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, I ndryshuar
- Njohuri mbi ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Njohuri mbi udhëzimin nr.14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e Pushtetit Vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”
- Njohuri mbi VKM 25, datë 20.01.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.248, datë 10.04.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit kontabël public, për organet e pushtetit local , institucionet shtetërore , qendrore dhe loklale, si dhe të njësite që varen prej tyre”
- Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012, I Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”

-

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Kandidatët do të vlerësohen për përvorjen, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al” <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Korçë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e Bashkisë Korçë, duke filluar nga data **20.01.2018**.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formësë prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:
- g- Diplomë bachelor edhe master profesional në shkenca ekonomike

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen pranë njësisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Korçë ose nëpërmjet shërbimit postar, Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **23.01.2018**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 01.02.2018, Bashkia Korçë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen

individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Korçë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Njohuri mbi ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar
- Njohuri mbi ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, I ndryshuar
- Njohuri mbi ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Njohuri mbi udhëzimin nr.14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e Pushtetit Vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”
- Njohuri mbi VKM 25, datë 20.01.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.248, datë 10.04.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit kontabël public, për organet e pushtetit local , institucionet shtetërore , qendrore dhe loklale, si dhe të njësisve që varen prej tyre”
- Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012, I Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al” <http://dap.gov.al/2014-03-21-12->

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Korçë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive: për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi; Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Korçë duke filluar nga data **01.02.2018**.

KRYETARI

SOTIRAQ FILO